



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:349589

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06593749

**P.nr.259/24**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i përgjithshëm**, Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale, të akuzuarit M.K., për shkak veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-Gjakovë PP/II.nr.1079/22 të dt. 05.12.2024, me propozimin për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës për shqyrtimin gjyqësor me dt.13.12.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e PTH-Gjakovë Gjakovë PP/II.nr.1079/22 të dt. 05.12.2024, ndërsa Gjykata, jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

**I AKUZUARI: M.S.K.**, lindur me dt..., në fshatin B. komuna e Malishevës ku edhe jeton, me nr personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak në kohë të papërcaktuar gjatë vitit 2022, në fshatin B., K. Malishevë, i pandehuri me qëllim që të pengojnë realizimin e së drejtës pronësore nga ana e të dëmtuarës O. I. K., tjetërson sendin në të cilën e dëmtuara ka të drejtën e pengut me qëllim që të pengoj pagesën e borxhit gjatë ekzekutimit të detyrueshëm, në atë mënyrë që i pandehuri me rastin e marrjes së kredisë nga e dëmtuara, si të drejtë pengu kishte lënë Traktorin I. ... me numër serik ..., i cili edhe nuk arin që të paguaj borxhin me kohë, andaj me dt.16.06.2022 e dëmtuara së bashku me përmbaruesin privat dalin në terren për sekuestrimin e pengut, mirëpo aty i pandehuri i njofton se pengu i lënë në bazë të marrëveshjes së kredisë e kishte shitur/tjetërsuar, me ç' rast te e dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material.

-Me çka ka kryer veprën penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së

Andaj Gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 332 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 360, 364, 453, 462 dhe 495, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i`a shqipton:

## DËNIMIN ME GJOBË

Me dënimin me gjobë në shumën prej **katërqind (400)** euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse dënimin e shqiptuar në të holla nuk e paguan në afatin e cekur. i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgim në njëzet (20) ditësh, duke llogaritur çdo ditë të filluar burgimi nga 20 €.

Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor, Gjykatës t'ia kompenzon shumën prej njëzet (20) euro, për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime të procedurës nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara O. I.K.nga P., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

## A r s y e t i m

PTH-Gjakovë me aktakuzën PP/II. nr. 1079/22 të dt. 05.12.2024, me propozim për dhënien e urdhrit ndëshkimor, e ka akuzuar M.K., për shkak të veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore i personit tjetër nga neni 332 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që ta pranon kërkesën për urdhër ndëshkimor, më të cilin të akuzuarit t'i dënon me dënimin me gjobë.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes penale, vërtetoi se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 dhe neni 495 të KPPK së, e aprovoi propozimin e PTH-së për dhënien e urdhrit ndëshkimor, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Është vlerësim i gjykatës se provat që i janë të bashkangjitura propozimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, e të cilat gjinden në shkresat lëndës janë: Kontrata mbi kredinë Nr...., dt.21.10.2019, marrëveshje pengu me klientin, Nr...., deklarata e të dëmtuarës V. P. e dhënë në polici me dt.29.07.2022, deklarata e te dyshuarës A. K. e dhënë në Polici me dt.01.09.2022, deklarata e te pandehurit M.K. e dhënë në Polici me dt.25.07.2022, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, e që janë prova të besueshme dhe të mjaftueshme për gjykatën për ta shpallur fajtor të akuzuarin.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështet në nenin 449 par.1 dhe 2 KPPK-së, ndërsa vendimin në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimit e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.256/24 me dt. 13.12.2024.**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të te njëjtit, kësaj Gjykate, në të kundërtën nëse i akuzuari nuk e ushtron kundërshtimin, aktgjykim do ta marr formën e prerë.